

VENDIM
Nr. 163, datë 19.7.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ReNRGY TRADING GROUP” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 465, datë 22.6.2017, shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152, datë 3.7.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 55/46 prot., datë 3.7.2018, u bë njoftimi në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 465/1 prot., datë 11.7.2018, iu kërkuar subjektit të plotësojë dokumentacionin e munguar.

- Subjekti “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 465/2 prot., datë 11.7.2018, paraqiti në ERE dokumentacionin e munguar.

- Në përfundim të afatit, 10 ditë pune, të përcaktuar në nenin 10, pika 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti